

DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE PËR PERSONAT E PASTREHË TË QYTETIT TË NJU-JORKUT (NEW YORK CITY DEPARTMENT OF HOMELESS SERVICES)

Njoftim për seancë dëgjimore publike dhe për mundësinë për të komentuar rreth rregullave të propozuara

Çfarë po propozojmë? Departamenti i Shërbimeve për Personat e Pastrehë të Qytetit të Nju-Jorkut (“DHS”) po propozon një rregull rreth njoftimit të caktimit të vendndodhjes së strehës.

Kur dhe ku do të mbahet seanca dëgjimore? Seanca dëgjimore publike do të zhvillohet virtualisht nëpërmjet aplikacionit Zoom të hënën, më 2 dhjetor të 2024-s, në orën 10:00 të paradites. Ata që dëshirojnë të marrin pjesë në seancë mund të bashkohen nëpërmjet:

Zoom-it (video dhe audio): <https://www.zoomgov.com/j/1611099761>

Ose vizitoni www.zoom.us, klikoni “bashkohu në takim” dhe vendosni ID-në e takimit: 161 109 9761

Telefonit (vetëm audio): 1-646-828-7666

Kur t’ju kërkohet, vendosni ID-në e takimit: 161 109 9761

Si t’i komentoj rregullat e propozuara? Çdokush mund t’i komentojë rregullat e propozuara nëpërmjet:

- **Faqes së internetit.** Mund t’i dërgoni komente DHS-së me anë të faqes së internetit të rregullave të qytetit të Nju-Jorkut në <http://rules.cityofnewyork.us>.
- **Emailit.** Mund t’i dërgoni komentet me email në adresën DHSRules@dhs.nyc.gov. Ju lutemi të përfshini “Njoftim për caktimin në strehën e DHS-së” në subjekt.
- **Postës.** Ju mund t’i dërgoni me postë komentet në:

DHS Rules
c/o Office of Legal Affairs
150 Greenwich Street, 38th Floor
New York, NY 10007

Ju lutemi bëjeni të qartë se po komentoni rregullin e njoftimit të caktimit të vendndodhjes së strehës.

- **Faksit.** Ju mund t’i dërgoni komentet me faks në numrin 917-639-0413. Ju lutemi të përfshini “Njoftim për caktimin në strehën e DHS-së” në subjekt.
- **Të folurit në seancë.** Mund të regjistroheni për të folur në seancë duke telefonuar në numrin 929-221-7220 ose duke dërguar email në DHSRules@dhs.nyc.gov në datën e fillimit ose para fillimit të seancës dëgjimore të hënën, më 2 dhjetor të 2024-s, në orën 10:00 të paradites. Folësit do të thirren sipas radhës që janë regjistruar dhe do të mund të flasin deri në tre minuta. Ju lutemi vini re se seanca është vetëm për pranimin e dëshmisë verbale dhe nuk mbahet në formatin “Pyetje dhe përgjigje”.

A ka afat për paraqitjen e komenteve? Po. Afati i fundit për të dorëzuar komentet është në mesnatë, të hënën, më 2 dhjetor të 2024-s. Komentet, duke përfshirë ato të dërguara me postë, duhet të merren nga HRA-ja, më 2 dhjetor të 2024-s ose përpara kësaj date.

Po sikur të më duhet ndihmë për të marrë pjesë në seancë? Ju duhet të na thoni nëse keni nevojë për shërbime të interpretimit gjuhësor ose një akomodim të arsyeshëm për të marrë pjesë në seancë. Mund të na e thoni me email në adresën DHSRules@dhs.nyc.gov. Ju gjithashtu mund të na e thoni me telefon në numrin 929-221-7220. Kërkohet njoftim paraprak për të lënë kohë të mjaftueshme për të bërë ndryshime. Na njoftoni deri më 25 nëntor 2024, në orën 17:00.

A mund t'i rishikoj komentet e bëra mbi rregullat e propozuara? Ju mund t'i rishikoni komentet e bëra online për rregullat e propozuara duke vizituar faqen e internetit <http://rules.cityofnewyork.us/>. Menjëherë pas seancës dëgjimore, kopjet e të gjitha komenteve të dorëzuara online, kopjet e të gjitha komenteve me shkrim dhe përmbledhja e komenteve verbale në lidhje me rregullin e propozuar do të vihen në dispozicion të publikut në faqen e internetit të DHS-së.

Çfarë e autorizon DHS-në të vendosë këtë rregull? Seksionet 603 dhe 1043 të Aktit Themelues të Qytetit. Ky rregull i propozuar nuk ishte përfshirë në axhendën rregullatore të DHS-së për këtë vit tatimor.

Ku mund t'i gjej rregullat e DHS-së? Rregullat e DHS-së gjenden në Pjesën 31 të Rregullave të Qytetit të Nju-Jorkut.

Cilat rregulla e drejtojnë procesin e vendosjes së rregullave? DHS-ja duhet të plotësojë kërkesat e seksionit 1043 të Aktit Themelues të Qytetit kur krijon ose ndryshon rregullat. Ky njoftim është bërë sipas kërkesave të seksionit 1043(b) të Aktit Themelues të Qytetit.

Deklarata e Bazës dhe Qëllimit

Në vitin 2019, Senati i Shtetit të Nju-Jorkut miratoi ligjin (S.7215-A), i cili propozoi ndryshimin e seksionit 21-324 të Kodit Administrativ të Qytetit të Nju-Jorkut ("Administrative Code") për t'i kërkuar Departamentit të Shërbimeve për Personat e Pastrehë të Qytetit të Nju-Jorkut ("DHS" ose "Department") që të zhvillonte një seancë dëgjimore publike në distriktin e komunitetit rreth vendndodhjes së një strehe të re për personat e pastrehë para se të caktohet vendndodhja. Qëllimi i ligjit ishte promovimi i llogaridhënies dhe transparencës duke lejuar që anëtarë të interesuar të komunitetit dhe zyrtarë të përzgjedhur të shprehin shqetësimet e tyre, duke përfshirë ato rreth sigurisë publike, transportit dhe aksesueshmërisë së arsimit, në lidhje me një strehë të propozuar për personat e pastrehë. Projektligji u miratua si ligj dhe u shndërrua në Kreun 383 të ligjeve të vitit 2020.

Megjithatë, Kreu 68 i ligjeve të vitit 2021 ndryshoi më tej seksionin 21-324 për të kërkuar seanca të informimit publik në vend të seancave dëgjimore publike për arsye se kërkesa për një seancë dëgjimore publike mund të shkaktojë vonesa të panevojshme në procesin e caktimit të vendndodhjes së strehës. Seancat e informimit publik do të vazhdojnë t'i ofrojnë publikut mundësinë për t'i shprehur pyetje dhe shqetësime DHS-së rreth strehëve të propozuara dhe vendndodhjeve të tyre pa shkaktuar vonesa të panevojshme.

Seksioni 21-324, sipas ndryshimeve, vendos disa kërkesa për DHS-në. Së pari, i kërkon DHS-së të "përcaktojë një proces për njoftimin rreth strehëve të reja për personat e pastrehë," i cili duhet të përfshijë njoftimin e zyrtarëve të përzgjedhur lokalë dhe bordit të komunitetit në të cilin streha do të ketë vendndodhjen. Së dyti, kërkon që t'u dërgohen njoftime vjetore zyrtarëve të përzgjedhur federalë,

shtetërorë dhe lokale që kërkojnë vendndodhje të mundshme për strehë të ardhshme. Së fundmi, i kërkon DHS-së që të “zhvillojë të paktën një seancë të informimit publik rreth caktimit të vendndodhjes së çdo strehe të re” në distriktin e komunitetit ku kjo strehë do të ketë vendndodhjen dhe të publikojë orarin dhe vendin ku do të zhvillohet kjo seancë e informimit publik jo më vonë se katërmëdhjetë ditë para zhvillimit të kësaj seance.

Për të përmbushur këtë detyrim, DHS-ja propozon të përfshijë Kreun e ri numër 6 brenda Pjesës 31 të Rregullave të Qytetit të Nju-Jorkut (“RCNY”) për zbatimin e procedurave të njoftimit dhe informimit publik për strehët e reja.

Autoriteti i Departamentit për këtë rregull të propozuar gjendet në seksionet 389, 612 dhe 1043 të Aktit Themelues dhe seksionin 21-324 të Kodit Administrativ.

Materiali i ri është nënvizuar.

[Materiali i fshirë është në kllapa.]

Yjet (***) tregojnë tekstin e pandryshuar.

“Do të” dhe “duhet të” nënkuptojnë kërkesa të detyrueshme dhe mund të përdoren në mënyrë të ndërkëmbyeshme të rregullat e Departamentit, përveçse kur specifikohet ndryshe ose kur konteksti i referohet qartësisht diçkaje tjetër.

Seksioni 1. Pjesa 31 e Rregullave të Qytetit të Nju-Jorkut ndryshohet duke shtuar kreun e ri numër gjashtë që lexon si më poshtë:

Kreu 6: Publikimi i informacionit në lidhje me strehët e reja për personat e pastrehë

§ 6-01. Përkufizime. Siç përdoren në këtë kre, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

(a) “Zhvillimi” do të thotë drejtimi, kontrollimi, organizimi, pritja, koordinimi ose pjesëmarrja në një seancë të informimit publik.

(b) “Departament” nënkupton departamentin e shërbimeve për personat e pastrehë të qytetit të Nju-Jorkut.

(c) “Strehë e re” nënkupton një godinë që nuk është përdorur më parë nga departamenti si strehë.

(d) “Seancë e informimit publik” do të thotë një takim, konferencë, mbledhje ose grumbullim tjetër fizik, virtual apo në distancë i organizuar nga stafi i departamentit dhe është i hapur për publikun.

(e) “Strehë” nënkupton çdo godinë të krijuar dhe përdorur nga departamenti ose një ofrues me kontratë ose marrëveshje të ngjashme me departamentin me qëllim ofrimin e kujdesit të të përkohshëm rezidencial për personat e rritur të pastrehë, familjeve me persona të rritur ose familje me fëmijë që aplikojnë për ose janë në pritje të ndihmës së strehimit të përkohshëm.

(f) “Strehë për raste emergjente” nënkupton çdo godinë me akomodim për të fjetur, qëllimi kryesor i të cilës është të ofrojë strehim të përkohshëm për marrësit e ndihmës së strehimit të përkohshëm dhe që është e hapur gjatë një gjendjeje emergjence e deklaruar nga Kryetari i Bashkisë sipas seksionit 24 të Ligjit Ekzekutiv ose nga Guvernatori sipas seksionit 28 të këtij ligji, ose sipas një prokurimi emergjent.

§ 6-02. Procesi i njoftimit për një strehë të re për personat e pastrehë.

(a) Pasi ka identifikuar një strehë të re, por para se të regjistrojë një kontratë në zyrën e kontrolluesit të qytetit për përdorimin e kësaj strehe, departamenti do të:

(1) Njoftojë me shkrim të gjithë zyrtarët e përzgjedhur federalë, shtetërorë dhe lokalë, si dhe bordin e distriktit të komunitetit në të cilin streha e re e propozuar do të ketë vendndodhjen, duke i informuar për këtë godinë dhe për qëllimin e departamentit për të caktuar një strehë në atë godinë. Ky njoftim do të përfshijë:

(i) vendndodhjen e strehës së re të propozuar;

(ii) kapacitetin e strehës së re të propozuar;

(iii) popullsinë të cilës streha e re e propozuar do t’i shërbejë;

(iv) emrin e ofruesit të shërbimit të përzgjedhur për të drejtuar strehën e re të propozuar, nëse ka;
dhe

(v) datën e parashikuar të hapjes së strehës së re të propozuar; dhe

(2) Zhvillojë të paktën një seancë të informimit publik në të cilën pjesëtarë të publikut mund të bëjnë pyetje dhe komente në distriktin e komunitetit ku do të caktohet vendndodhja e strehës së re të propozuar;

(3) Publikojë në faqen e internetit të departamentit datën, orarin dhe vendin ku do të zhvillohet, ose linkun e kësaj seance të informimit publik, si edhe adresën e strehës së re të propozuar, jo më pak se 14 ditë para planifikimit të kësaj seance; dhe

(4) Pranojë pyetjet dhe komentet me shkrim rreth propozimit për të caktuar vendndodhjen e një strehe të re brenda 14 ditëve nga seanca e informimit publik.

(b) Procedurat në këtë seksion nuk zbatohen për strehët për raste emergjente, me kusht që në rastet emergjente kur streha do të veprojnë përtej kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës sipas të cilës streha u krijua, departamenti do të veprojnë në përputhje me kërkesat e njoftimit të përshkruara në këtë seksion para regjistrimit të çfarëdo kontrate ose marrëveshje me kontrolluesin e qytetit për të përdorur një strehë në të njëjtën vendndodhje.

(c) Jo më vonë se 31 marsi i çdo viti kalendarik, departamenti do t'i dërgojë njoftim me shkrim, në mënyrë elektronike dhe me postë, të gjithë zyrtarëve të përzgjedhur federalë, shtetërorë dhe lokalë duke kërkuar që këta zyrtarë të identifikojnë vendndodhjet e mundshme për strehët e reja në distriktet e tyre.

NEW YORK CITY LAW DEPARTMENT
DIVISION OF LEGAL COUNSEL
100 CHURCH STREET
NEW YORK, NY 10007
212-356-4028

VËRTETIM NË PËRPUTHJE ME
SEKSIONIN 1043(d) TË AKTIT THEMELUES

PJESA E RREGULLAVE: Rregullat e publikimit të informacionit për strehët e reja për personat e pastrehë

NUMRI REFERUES: 2023 RG 107

AGJENCIA E VENDOSJES SË RREGULLAVE: Departamenti i Shërbimeve për Personat e Pastrehë të Qytetit të Nju-Jorkut

Unë vërtetoj që kjo zyrë ka shqyrtuar rregullin e propozuar të referuar më sipër siç kërkohet nga seksioni 1043(d) i Aktit Themelues të Qytetit të Nju-Jorkut dhe që rregulli i propozuar i referuar më sipër:

- (i) është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbushë qëllimet e dispozitave autorizuese të ligjit;
- (ii) nuk është në kundërshtim me rregullat e tjera të zbatueshme;
- (iii) në masën e zbatueshme dhe të përshtatshme, është hartuar posaçërisht për të arritur qëllimet e caktuara; dhe
- (iv) në masën e zbatueshme dhe të përshtatshme, përmban një deklaratë për bazën dhe qëllimin që jep një shpjegim të qartë të rregullit dhe të kërkesave të caktuara nga rregulli.

/s/ STEVEN GOULDEN
Këshilltar i Lartë

Data: 29 tetor 2024

**NEW YORK CITY MAYOR'S OFFICE OF OPERATIONS
253 BROADWAY, 10th FLOOR
NEW YORK, NY 10007
212-788-1400**

**VËRTETIM / ANALIZË
NË PËRPUTHJE ME SEKSIONIN 1043(d) TË AKTIT THEMELUES**

PJESA E RREGULLAVE: Rregullat e publikimit të informacionit për strehët e reja për personat e pastrehë

NUMRI REFERUES: DHS-6

AGJENCIA E VENDOSJES SË RREGULLAVE: Departamenti i Shërbimeve për Personat e Pastrehë

Unë vërtetoj që kjo zyrë ka analizuar rregullin e propozuar të referuar më sipër siç kërkohet nga seksioni 1043(d) i Aktit Themelues të Qytetit të Nju-Jorkut dhe që rregulli i propozuar i referuar më sipër:

- (i) Është i kuptueshëm dhe i shkruar në gjuhë të thjeshtë për komunitetin ose komunitetet e rregulluara në mënyrë të veçantë;
- (ii) Minimizon kostot e pajtueshmërisë për komunitetin ose komunitetet e rregulluara në mënyrë të veçantë në përputhje me arritjen e qëllimit të deklaruar të rregullit; dhe
- (iii) Nuk ofron një periudhë korrigjuese, pasi nuk përcakton ndonjë shkelje, modifikim shkeljeje ose modifikim të penaliteteve të lidhura me një shkelje.

/s/ Francisco X. Navarro
Zyra e Operacioneve e Kryetarit të Bashkisë

29 tetor 2024
Data